



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 59, datë 24.04.2019

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VLERËSIMIN E STATUSIT
INDIVIDUAL DHE KARRIERËN E INSPEKTORËVE TË ISH-KËSHILLIT TË LARTË
TË DREJTËSISË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 62, pika 14 e ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 168 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për të rregulluar situatën e krijuar për inspektorët e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në kushtet kur ende nuk është krijuar institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin e Statusit Individual dhe karrierën e inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të përbërë nga tre anëtarë, dy anëtarë jo gjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar.
2. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këtij Komisioni, bëhet me short, sipas mënyrës dhe procedurës së parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi. Kryetarja e Këshillit nuk është pjesë e këtij Komisioni ndaj dhe përjashtohet nga hedhja e shortit.
3. Komisioni i Përkohshëm, për të përmbushur detyrën e tij duhet të shqyrtojë dosjet personale të Kryeinspektorit dhe secilit inspektor, duke evidentuar të dhënat individuale të tyre si:
 - a) historinë e arsimimit të tyre;
 - b) vjetërsinë në ushtrimin e detyrës si gjyqtar ose si jurist;
 - c) emërimin për herë të parë, si inspektor pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - d) gjykatën nga e cila kanë ardhur ose institucionin apo profesionin që kanë ushtruar para se të emërohen si inspektor;
 - e) për inspektorët të cilët nuk kanë ardhur nga gjykatat të evidentohet shkaqet për të cilat ato kanë ndërprerë marrëdhëniet me gjyqësorin;
 - f) numrin e mandateve si inspektor, evidentimin e emërimin të fundit si inspektor dhe mbarimin tij;

- g) detyrën që kanë ushtruar inspektorët, bazuar në urdhrat e titullarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për ndarjen në seksione të inspektoratit;
- h) inspektorët të cilët i janë nënshtruar testimit profesional të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës;
- i) të dhëna për masa disiplinore;
- j) Çdo të dhënë tjetër që ndodhet në dosjen e inspektorit dhe që ndihmon në përmbushjen e qëllimit të Komisionit.

3.1 Bazuar në të dhënat e mësipërme, në historikun profesional, Komision harton një raport për Këshillin, në të cilin duhet të evidentohen:

- a) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me vlerësimin profesional dhe etik të gjyqtarëve;
- b) inspektorët, veprimtaria e të cilëve ka qenë në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësi lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve;
- c) inspektorët të cilët gëzojnë statusin e magjistratit dhe cilët ndër inspektorë nuk e gëzon këtë status.
- d) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur ndërmjet gjyqtarëve që përmbushin kriteret për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit;
- e) inspektorët të cilët janë emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë duke u përzgjedhur, ndërmjet juristëve që kanë shërbyer si gjyqtar jo më pak se 5 vjet;
- f) dhënia e pëlqimit nga secili inspektorë për të vijuar ushtrimin e veprimtarisë pranë KLGJ-së deri në krijimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

4. Komisioni i Përkohshëm dokumenton çdo mbledhje në një përmbledhje procesverbali dhe asistohet në punën e tij nga nëpunës të administratës të caktuar nga Kryetari i Këshillit. Brenda 2 (dy) javëve, nga ngritja e tij, Komisioni depoziton pranë Këshillit, raportin sipas përcaktimit në pikën 3.1 të këtij vendimi.

5. Shorti për zgjedhjen e anëtarëve të këtij komisioni, në funksion të pikës 2 të këtij vendimi, organizohet në 1 kuti/vazo transparente në të cilën vendosen goglat të cilat përmbajnë shiritat e letrës me togfjalëshat “anëtar i komisionit” dhe “jo anëtar i komisionit”. Hedhja e shortit bëhet sipas procedurës dhe radhës së mëposhtme:

- a) Përzgjedhja e anëtarit jo gjyqtarë - Në një vazo transparente futen 4 gogla të njëjta, sa është numri i anëtarëve jo gjyqtarë të mbetur, pas veçimit nga ky proces të Kryetares së Këshillit. Në dy prej goglave futet një shirit letre me togfjalëshin “anëtar i komisionit” dhe në dy goglat e tjera futet nga një shirit letre me togfjalëshin “jo anëtar i komisionit”. Anëtarët jo gjyqtarë të Këshillit, tërheqin me radhë nga një gogël secili, duke lexuar me zë të lartë përmbajtjen e shënimit e duke e treguar këtë para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve. Në përfundim, nga ky prezantim, dy anëtarë jo gjyqtarë do të jenë anëtarë të komisionit.
- b) Përzgjedhja e anëtarëve gjyqtarë - Në një vazo transparente futen 6 gogla të njëjta, sa është numri i anëtarëve gjyqtarë. Në një prej goglave futet një shirit letre me togfjalëshin “anëtar i komisionit” dhe në 5 goglat e mbetura, futet një shirit letre me togfjalëshin “jo anëtar i

komisionit”. Anëtarët gjyqtarë të Këshillit, tërheqin me radhë nga një gogël secili, duke lexuar me zë të lartë përmbajtjen e shënimit e duke e treguar këtë para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve. Në përfundim nga ky prezantim një anëtar gjyqtarë do të jetë anëtar i këtij komisioni.

6. Anëtarë të këtij Komisioni të përkohshëm, të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, pas hedhjes së shortit, janë:
 1. Znj. Fatmira Luli – anëtare,
 2. Z. Maksim Qoku – anëtar,
 3. Z. Medi Bici – anëtar.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni i Përkohshëm si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, për të vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e disponueshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR